

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

**DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË**

**PROGRAMI GJEOGRAFI**



## **PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**Kuptimi i preferencave të destinacionit turistik të turistëve kosovarë: një analizë lokale empirike**

Mentori/ja:

Prof. ass. dr. Fitim Humolli

Kandidati/ja:

Qëndresa Zeneli

*Prishtinë, 2025*

## ABSTRAKT

Studimet e deritanishme kanë treguar për një përqendrim të potencialeve turistike të cilat e zhvillojnë dhe e forcojnë imazhin e Kosovës si një vend i pasur me bukuri natyrore dhe kulturore dhe me premisa të konsiderueshme turistike. Kjo ndër të tjera, me qëllim tërheqjen e sa më shumë turistëve në mënyrë që nga to, të kishte përfitime në aspekte të shumta. Megjithatë, po aq thelbësore dhe e rëndësishme është edhe njohja e preferencave të turistëve kosovarë në përzgjedhjen e destinacionit, motivet dhe pritshmëritë e tyre. Procesi i vendimmarrjes për zgjedhjen e destinacionit turistik paraqet një kompleksitet në vete, dhe kjo ka nxitur realizimin e studimeve të shumta nga disiplina të ndryshme, megjithatë kërkimet specifike për preferencat dhe vendimmarrjen e turistëve kosovarë mungojnë. Nisur nga ky fakt, studimi synon dhe ka për qëllim të vendosë kosovarin në rolin e turistit, të identifikojë motivet dhe faktorët që formësojnë preferencat e tyre turistike, përfshirë zgjedhjen e destinacionit, aktivitetet e preferuara gjatë udhëtimit, llojet e preferuara të turizmit dhe jo vetëm. Në mënyrë që të sigurohet një kuptim i thellë dhe i plotë i tyre, hulumtimi përdori një qasje metodologjike të bazuar kryesisht në metoda empirike sasiore, ku anketa shërbeu si instrument kryesor për mbledhjen e të dhënave. Popullata burimore për këtë studim përfshin grupmosha aktive nga të gjithë turistët kosovarë, përkatësisht ata mbi 18 vjeç. Kjo pikërisht për të përfshirë në studim atë popullacion i cili konsiderohet që përzgjedh dhe udhëton, ose mund të udhëtojë për turizëm. Mostra është përzgjedhur nga kjo popullatë me qëllim që rezultatet të mund të përgjithësohen në masën që e lejon metoda e përdorur. Të rinjtë nën moshën 18 vjeç nuk janë përfshirë në hulumtim sepse konsiderohet që nuk kanë autonomi në vendimet për udhëtime dhe shpenzime turistike. Procesi i përzgjedhjes së një destinacioni turistik, së bashku me faktorët që e ndikojnë atë, përbën një çështje komplekse dhe me rëndësi të veçantë, pasi ndikon si në përvojën e turistit, ashtu edhe në zhvillimin e destinacionit turistik. Rezultatet dëshmojnë se destinacionet më të preferuara janë kryesisht rajonale, me Shqipërinë në krye, ndjekur nga Mali i Zi, Maqedonia Veriore, Turqia, dhe Greqia. Zgjedhja e këtyre destinacioneve lidhet ngushtë me afërsinë gjeografike, ngjashmërinë kulturore, kostot më të përballueshme dhe mundësitë për pushime familjare dhe rekreacion. Kjo tregon se lidhjet

kulturore dhe sociale mbeten faktor kyç në vendimmarrjen turistike të qytetarëve kosovarë. Rrjeti i destinacioneve turistike është transformuar si përgjithësisht, ashtu edhe për kosovarët, si rezultat i liberalizimit të vizave që nga viti 2024, e cila hapi dyert për turistët kosovarë drejt Greqisë, Italisë dhe vendeve të tjera të BE-së. Sa i përket llojeve të turizmit, turizmi bregdetar është më i preferuari, i ndjekur nga turizmi malor/hiking dhe turizmi kulturor. Motivet kryesore të udhëtimit përfshijnë pushimin, relaksim dhe argëtimin, ndërsa motive të tjera si zhvillimi personal, eksplorimi kulturor dhe aktivitetet fizike kanë gjithashtu rëndësi. Rezultatet tregojnë që turistët kosovarë kërkojnë kombinim të përvojave relaksuese, kulturore dhe argëtuese, duke reflektuar një diversitet të preferencave dhe nevojave. Nga analizimi i të dhënave të mbledhura, pjesëmarrësit u klasifikuan në tre profile turistike kryesore: psikocentrikë (44,5%), që preferojnë destinacione të sigurta dhe të organizuara mirë; mediocentrikë (39,25%), të cilët janë fleksibël dhe kombinojnë komoditetin me eksperiencën të reja; dhe allocentrikë (16,25%), që kërkojnë eksperiencë autentike dhe destinacione të pazbuluara, duke pranuar më shumë pasiguri. Ky shpërndarje pasqyron diversitetin e preferencave turistike dhe qëndrimeve ndaj aventurës dhe sigurisë. Kohëzgjatja më e zakonshme e udhëtimit për qëllime turistike është 2–5 ditë ose 1 javë, duke reflektuar një tendencë për udhëtime të shkurtra dhe mesatare që mundësojnë pushime të shpeshta pa ndikim të madh ekonomik apo profesional. Ndërkaq, destinacionet më të largëta kërkojnë kohë më të gjatë (10 ditë – 2 javë) dhe zakonisht kombinim të mjeteve të transportit (avion + veturë). Tendencat gjeografike tregojnë se qytetarët kosovarë preferojnë destinacionet më afër dhe me lidhje kulturore të ngushta, duke u fokusuar kryesisht tek Evropa Juglindore dhe Jugore, ndërsa destinacionet më të largëta kanë pjesëmarrje më të ulët. Rezultatet ofrojnë një bazë të fortë për zhvillimin e politikave turistike, strategjive marketingu dhe ofrimin e produkteve turistike të përshtatura me preferencat reale të turistëve. Të kuptuarit e preferencave turistike mund të ndihmojë në zhvillimin e strategjive më të mira në promovimin e turizmit për destinacionet që synojnë të tërheqin turistë nga ky treg dhe në anën tjetër duke reduktuar kështu varësinë nga një treg i vetëm. Ofrimi i përvojave që plotësojnë kërkesat e turistëve nxit një nivel të lartë të kënaqësisë, prandaj ky studim rekomandon ndërmarrjen sa më të plotë të aktivitetit hulumtues në funksion të përvojave praktike.

Fjalë kyçe: Kosova, preferenca turistike, turisti kosovar, destinacione turistike, faktorët, motivet